



This programme is funded
by the European Union



Raport monitorimi

“Ndihma juridike e garantuar nga shteti”

RAPORT

MBI ZBATIMIN E LIGJIT PËR NDIHMËN JURIDIKE TË GARANTUAR
NGA SHTETI, PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE DHE TË
TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

PERIUDHA E MONITORIMIT: JANAR - DHJETOR 2021

TIRANË, SHTATOR 2022

Ky raport u hartua në kuadrin e projektit: “*Forcimi i rolit të Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore*”, pjesë e projektit rajonal të UN Women “**Fund dhunës ndaj grave në Ballkanin perëndimor dhe Turqi: Zbatojmë normat, ndryshojmë mendësitë**” i cili financohet nga Bashkimi Evropian.

Mohimi i përgjegjësisë:

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e autorëve dhe kontribuesve dhe në asnjë rast nuk reflekton apo përfaqëson domosdoshmërisht mendimin apo qëndrimin e Komisionit Evropian dhe UN Women.

Përgatitën të dhënat: Av. Iris Aliaj, Av. Lirie Dina, Msc Klea Cahani, LLM Ilvana Dedja.

Përgatiti raportin: Prof. Dr. Av. Aurela Anastasi

©Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për autorët e këtij studimi. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Rr. “Vaso Pasha”, Pallati 12, Shk.1, Ap.1, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2259795, Cel: +355 672754655

Email: avokatore2@yahoo.com

Website: www.qag-al.org

SHKURTIME

OJF	Organizata Jofitimprurëse
QNL	Qendra për Nisma Ligjore Qytetare
QSHNJP	Qendra të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore
MD	Ministria e Drejtësisë
KSHNJ	Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike në Shqipëri
DNJF	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në Shqipëri
KM	Këshilli i Ministrave
Ligji nr.111/2017	Ligji nr.111/2017 “Për Ndhmën Juridike të garantuar nga Shteti”
Ligji nr.10039/2008	Ligji nr.10039, datë 22.02.2008 “Për ndihmën juridike”, i shfuqizuar
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
KL	Klinikat e Ligjit
Konventa e Stambollit	Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
Kushtetuta	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
LDH	Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar
KF	Kodi i Familjes
KPrC	Kodi i Procedurës Civile
UMM	Urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes
UM	Urdhër mbrojtje
IRSH	Intelektualët e Rinj Shkodër
UAMD	Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës
DHASH	Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë

PËRMBAJTJA E LËNDËS

SHKURTIME.....	3
I. QËLLIMI DHE BURIMET E RAPORTIT.....	7
II. NDIHMA JURIDIKE PARËSORE	9
1. Dy fjalë për ndihmën juridike parësore sipas ligjit	9
1.1. Kuptimi	9
1.2. Institucionet që ofrojnë ndihmën juridike parësore	9
1.3. Subjektet që përfitojnë ndihmë ligjore falas.....	10
III. REZULTATET NGA MONITORIMI I NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE	12
1. Shërbimi i ndihmës juridike parësore për vitin 2021	12
1.1. Ndihma juridike parësore e ofruar nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore	13
1.2. Profili i detajuar i viktimave që kanë përfituar ndihmë ligjore nga qendrat e shërbimit.....	14
1.3. Shërbimet që janë ofruar në kuadrin e ndihmës juridike parësore nga qendrat e shërbimit	15
2. Ndihma juridike parësore e ofruar nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara	15
2.1. Numri i subjekteve të kategorive të veçanta që kanë marrë ndihmë juridike parësore nga OJF-të, Tiranë.....	16
2.2. Profili i detajuar i viktimave që kanë përfituar ndihmë ligjore nga OJF-të e autorizuara.....	17
2.3. Klinikat universitare të autorizuara.....	17

IV. REZULTATET NGA MONITORIMI I NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE	18
1. Një vështrim i ndihmës juridike dytësore sipas ligjit	18
2. Rezultatet nga monitorimi i vendimeve për përfitimin e ndihmës juridike dytësore dhe përjashtimin nga shpenzimet.....	19
2.1. Vendimet gjyqësore që u monitoruan.	19
3. Profili i viktimave.....	20
4. Lloji i çështjes	21
5. Paraqitja e kërkesës në gjykatë.....	21
6. Provueshmëria.....	22
V. PËRMBLEDHJE E KONKLUZIONEVE DHE REKOMANDIMEVE	23
1. Gjetjet kryesore nga monitorimi	23
1.1 Në lidhje me infrastrukturën institucionale	23
1.2 Në lidhje me subjektet që kanë përfituar ndihmë ligjore falas.....	24
1.3 Në lidhje me shërbimet e ofruara dhe gjetjet në fushën juridike.....	24
2. Rekomandime	25
VI. ANEX	27
Skeda e Monitorimit.....	27

I.

QËLLIMI DHE BURIMET E RAPORTIT

Ky raport ka qëllim të analizojë zbatimin e ligjit nr. 11/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga Shteti” dhe të arrijë në konkluzione e sugjerime që ndihmojnë për mirëzbatimin e tij. Monitorimi synon të japë ndihmesë për një sistem efektiv të ofrimit të ndihmës juridike falas. Ai mban në vëmendje objektivat e ligjit për të siguruar qasje të barabartë për të gjithë individët në sistemin e drejtësisë, duke garantuar ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, efikase dhe efektive.

Monitorimi u përqendrua në mbarëvajtjen e të tri formave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti:

- ofrimin e ndihmës juridike parësore,
- procesin për sigurimin e ndihmës juridike dytësore,
- procesin për përjashtimin nga të gjitha shpenzimet e procesit gjyqësor deri në ekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

Ai shtrihet në tri qarqe gjyqësore të vendit: Durrës, Shkodër, Tiranë, në periudhën Janar-Dhjetor 2021.

Raporti analizon vetëm qasjen e kategorive të veçanta të qytetarëve ndaj shërbimeve juridike të garantuara falas nga shteti, sikurse janë parashikuar nga ligji, sidomos: viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit. Ai analizon zbatimin e ligjit dhe garantimin e shërbimeve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, nga të gjithë ofruesit e parashikuar në ligj, si dhe vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore të sipërpërmendura.

Fokusi i monitorimit është funksionimi efektiv i sistemit të ndihmës juridike në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, viktimave fëmijë, viktimave të diskriminimit. Ai synon që përmes gjetjeve dhe konkluzioneve të tij, të ofrojë sugjerime për veprimtarinë e institucioneve përgjegjëse si dhe për avokatët që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë fushë.

Për realizimin e këtij monitorimi, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) u mbështet në eksperiencën e mëparshme në ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, si dhe në ekspertizën e avokatëve të Qendrës në punën me grupet në nevojë. U realizua përzgjedhja e avokatëve monitorues në të tri rrethet gjyqësore, të cilët u trajnuan nga ekspertë të fushës, me qëllim përdorimin e një metodologjie pune të unifikuar.

Ekspertët e projektit, punuan për hartimin e skedës monitoruese, e cila u përmirësua nga diskutimi gjerësisht me profesionistë të kësaj fushe (shih aneksin nr. 1). Mbi bazën e skedës, janë analizuar të gjitha vendimet gjyqësore që janë dhënë në kuadrin e ushtrimit të ndihmës ligjore falas në të tri rrethet gjyqësore objekt monitorimi. Gjithashtu, janë intervistuar organizata jofitimprurëse në Shqipëri, që kanë hartuar raporte të mëparshme me fokus ndihmën juridike falas. Janë realizuar intervista me avokatë, ofrues të shërbimeve ligjore dhe me ofrues të ndihmës juridike parësore në qytetet objekt monitorimi. Burimet e monitorimit kanë qenë vendimet gjyqësore, formularët e përdorur gjatë ofrimit të ndihmës juridike parësore dhe dokumente të ndryshme të vëna në dispozicion për qytetarët. Si burime për monitorimin kanë shërbyer edhe seancat e këshillimit që u janë ofruar viktimave të dhunës në familje nga subjektet që ofrojnë këtë ndihmë.

Me qëllim që sugjerimet e këtij studimi të jenë të mbështetura në të dhëna cilësore dhe sasore, janë marrë në konsideratë studime lidhur me sistemin e ri të ndihmës juridike në Shqipëri, të dhëna nga raportet e publikuara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, si dhe nga informacioni i vënë në dispozicion të QNL-së, mbi funksionimin e ndihmës juridike përgjatë vitit 2021.

Një analizë njohëse është realizuar për kuadrin ligjor të ndihmës juridike, duke përfshirë ligjin objekt monitorimi dhe aktet nënligjore të tij. Në vëmendje është mbajtur edhe zbatimi në praktikë i këtij legjislacioni dhe problemet që janë evidentuar gjatë punës nga subjektet ligjzbatuese si, qendrat e ndihmës juridike, organizatat jofitimprurëse dhe klinikat ligjore universitare. Kjo analizë u ka shërbyer ekspertëve për të përcjellë tek profesionistët e interesuar dhe tek institucionet shtetërore, të dhëna konkrete për efektivitetin e skemës së ndihmës juridike në Tiranë, Shkodër, Durrës, si dhe për të dhënë rekomandime për përmirësimin e sistemit në vijimësi.

II.

NDIHMJA JURIDIKE PARËSORE

1. Dy fjalë për ndihmën juridike parësore sipas ligjit

1.1. Kuptimi

Në kuptim të këtij ligji, ndihmë juridike parësore konsiderohet këshillimi dhe ndihma për hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore, përfaqësimin përpara organeve administrative, si dhe kryerjen e procedurave për të kërkuar ndihmë juridike dytësore. Ndhimja juridike parësore ofrohet edhe nëpërmjet këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve, si dhe të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike, që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Theksojmë se nëpërmjet ofrimit të ndihmës juridike parësore ligji garanton ndihmën ligjore falas për mbështetjen përpara institucioneve administrative, duke parashikuar këshillim ligjor për rastin, përgatitjen e akteve dhe përfaqësimin e kërkuarit përpara organeve administrative deri në zgjidhjen e çështjes administrativisht.

Një aspekt tjetër i ndihmës parësore është edhe edukimi ligjor i qytetarëve, me qëllim zgjidhjen e çështjeve nëpërmjet ndërmjetësimit.

Sikurse shihet, ligji orienton ndihmën juridike parësore në zgjidhjen e çështjeve pa shkuar në gjykatë, duke ndikuar edhe në zvogëlimin e numrit të rasteve që i drejtohen për zgjidhje gjykatës. Në këtë mënyrë përfitojmë zvogëlimin e kostove dhe kohës që harxhohet, duke zgjidhur konfliktet në një mënyrë më të thjeshtë. Në terma afatgjatë, kjo formë e ofrimit të ndihmës juridike parësore do të ndikojë në zvogëlimin e ngarkesës në gjykata dhe në rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor.

1.2. Institucionet që ofrojnë ndihmën juridike parësore

Ndhimja juridike parësore ofrohet pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (QSHNJP). Në kuptim të ligjit kjo qendër është njësi e specializuar për dhënien e ndihmës juridike parësore, e organizuar sipas legjisllacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Organi kompetent i qeverisjes qendrore që miraton krijimin e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore është Ministria e Drejtësisë (MD).

Mbi bazën e ligjit të ri të ndihmës juridike të garantuar nga shteti u krijua Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas (DNJF), e cila është në varësi të Ministrit të Drejtësisë. Kjo drejtori administron qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, që krijohen pranë gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore.

Përgjatë vitit 2021, funksionuan rregullisht dhe pa asnjë ndërprerje qendrat e ndihmës juridike falas përkatësisht, një në Tiranë e cila është ngritur dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë, një qendër pranë gjykatës së rrethit gjyqësor në Shkodër dhe një qendër pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Durrës.

Një nga risitë thelbësore të ligjit nr. 111/2017, është përcaktimi i organizatave jofitimprurëse (OJF) të autorizuar, si ofruese të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Nga monitorimi rezultoi se aktualisht, janë autorizuar organizata jofitimprurëse, që përmes eksperiencës së tyre shumëvjeçare sigurojnë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas për qytetarët, në qytetet e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Beratit, etj. Këto organizata jofitimprurëse janë specializuar në fusha të ndryshme të ndihmës ligjore, megjithatë, mjaft prej tyre japin ndihmë ligjore falas për kategoritë e veçanta në nevojë, objekt i këtij monitorimi.

Përgjatë vitit 2021, funksionuan rregullisht organizatat e autorizuar me kontratë nga (DNJF) përkatësisht, 8 OJF në Tiranë, dhe nga një OJF përkatësisht në Durrës e Shkodër.

Një ndër ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë edhe klinikat ligjore, të cilat krijohen kryesisht, pranë universiteteve. DNJF bashkëpunon me këto klinika sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit, për trajnimin, përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore (neni 16 i ligjit nr. 111/2017).

Përgjatë vitit 2021, funksionuan klinikat e ligjit të autorizuar pranë universiteteve, nga të cilat 8 klinika në Tiranë dhe përkatësisht nga një klinikë ligjore në Durrës e Shkodër.

Si përfundim, mund të themi se, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, organizatat jofitimprurëse të autorizuar dhe klinikat ligjore, ofrojnë ndihmë juridike parësore falas për çdo subjekt përfitues sipas përcaktimeve të ligjit. Të gjitha këto institucione kanë vendosur në dispozicion të qytetarëve zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, disa prej të cilave janë të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuar.

1.3. Subjektet që përfitojnë ndihmë ligjore falas

Ligji nr. 111/2017 ka përcaktuar edhe subjektet përfituese të ndihmës juridike falas, të cilat duhet të përmbushin disa kriterë të mirëpërcaktuara në ligj. Ato duhet të përfshihen ose në kategorinë e **përfituesve të ndihmës juridike me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme¹ ose si subjekte të veçanta të përfituesve të ndihmës juridike².**

¹ Neni 12 i ligjit nr. 111/2017.

² Neni 11 i ligjit 111/2017.

Subjektet përfituese të ndihmës juridike janë:

- shtetasit shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të përkohshme ose të përhershme dhe janë të pajisur me leje qëndrimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt;
- shtetasit e huaj, ose personat pa shtetësi, që hyjnë në mënyrë të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që përfitojnë mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë ose bazuar në parimin e reciprocitetit;
- azilkërkuesit, personat që gëzojnë statusin e refugjatit dhe personat që janë në proces ankimi të vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e aplikimit për azil ose revokimin e vendimit të statusit të refugjatit, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.

Përpos sa më sipër, Ligji ka parashikuar si përfitues subjektet e veçanta, të cilët/cilat përfitojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti pavarësisht të ardhurave apo pasurive të tyre.

Pjesë e këtyre kategorive janë:

- viktimat e dhunës në familje; viktimat e abuzuar seksualisht apo trafikimit të qenieve njerëzore;
- viktimat e mitur apo të miturit në konflikt me ligjin në çdo fazë të procedimit penal;
- fëmijët në kujdestari ose në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- personat me aftësi të kufizuar; të verbrit ose ata që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor;
- personat që u është hequr/kufizuar zotësia për të vepruar, si çdo person tjetër që i është cenuar e drejta përmes një veprimi/mosveprimi që përben diskriminim sipas legjislacionit në fuqi.

Konkluzion: Përgjatë periudhës objekt monitorimi gjejmë se, është krijuar kuadri i nevojshëm ligjor për ofrimin e ndihmës juridike parësore. Janë vënë në zbatim aktet nënligjore, duke garantuar shërbime ligjore falas të ndihmës juridike parësore në të tri qarqet objekt monitorimi.

III.

REZULTATET NGA MONITORIMI I NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

1. Shërbimi i ndihmës juridike parësore për vitin 2021

Ofruesit e ndihmës juridike parësore.

Nga monitorimi i ndihmës parësore në të tri rrethet Durrës, Shkodër, Tiranë, konstatuam se për ofrimin e kësaj ndihme janë ngritur dhe funksionojnë të tri kategoritë e institucioneve të parashikuara nga ligji, si vijojnë:

- Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore;
- Organizata jofitimprurëse të autorizuara;
- Klinikat e ligjit pranë universiteteve.

Mjaft prej tyre kanë ofruar ndihmë juridike falas për rastet e dhunës me bazë gjinore, veçanërisht të dhunës në familje dhe personave në rrezik për trafikimin e qenieve njerëzore.

Përveç tyre, për gjatë vitit 2021 në nivel kombëtar kanë funksionuar edhe Ndhima Juridike Parësore ONLINE (platformajuristionline.al), si dhe numri i gjelbër pa pagesë 08001010

Në vijim, kemi paraqitur numrin e subjekteve viktime të dhunës, të cilët kanë përfituar ndihmë ligjore falas për çështje të dhunës me bazë gjinore përgjatë vitit 2021.

1.1. Ndhimja juridike parësore e ofruar nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore

Tabela 1. Numri i subjekteve që kanë marrë ndihmë juridike parësore nga qendrat, sipas rretheve gjyqësore.

Qendrat e Shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore					
Durrës		Shkodër		Tiranë	
Shërbime gjithsej	Shërbime për subjektet e posaçme	Shërbime gjithsej	Shërbime për subjektet e posaçme	Shërbime gjithsej	Shërbime për subjektet e posaçme
379	16	585	48	300	15

Nga tabela e mësipërme, konstatojmë se në të tri qytetet funksionojnë qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, të cilat kanë ofruar shërbime për personat në nevojë si edhe për kategoritë e veçanta. Ato kanë shërbyer pa ndërprerje përgjatë gjithë vitit 2021, gjatë të cilit rezultoi se kanë marrë shërbime përkatësisht, gjithsej në Durrës 379 persona, në Shkodër 595 persona, kurse në Tiranë 300 persona.

Nga numri i përgjithshëm i personave që kanë marrë shërbime në secilin prej rretheve gjyqësore kategoria e viktimave të dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore dhe viktimave të diskriminimit, ka përbërë përkatësisht 4,2% të shërbimeve në Durrës, 1,2 % në Shkodër dhe 2% të shërbimeve në Tiranë.

Në qarkun Shkodër kanë kërkuar ndihmë parësore dhe kanë marrë shërbimin një numër më i madh subjektësh se sa në dy qarqet e tjera, Tiranë e Durrës. Megjithatë, duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të personave në nevojë që kanë marrë shërbim në Shkodër, raporti dëshmon një numër të vogël të kategorive të veçanta, gjithashtu. Mendojmë se shifrat e mësipërme nuk lidhen me numrin e popullsisë, apo me numrin e rasteve, por me faktorë të tjerë. Në realitet, Tirana është qarku me numrin më të madh të popullsisë dhe numrin më të madh të rasteve, por gjatë këtij viti QNJF ka ndjekur më pak raste se dy rrethet e tjera. Për vitin 2020 nuk arritëm në ndonjë konkluzion të qartë, pasi numri i shërbimeve ishte shumë i pakët edhe për shkak të pandemisë. Por, ne mendojmë se pozicionimi i Qendrës së shërbimeve juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë e pengon aksesin e personave në nevojë. Ajo është shumë larg gjykatave të shkallës së parë. Megjithatë, për Tiranën mund të ketë ndikuar fakti se aty janë përqendruar edhe shërbimet që japin organizatat jofitimprurëse të cilat janë të specializuara për kategoritë e veçanta.

Referimet që qendrat kryejnë tek OJF-të e specializuara mund të kenë një ndikim të dukshëm në numrin e shërbimeve për kategoritë e posaçme. Kjo situatë, mbetet që të monitorohet me më tepër hollësi në raste të tjera, duke përfshirë edhe raportet e referimet e rasteve midis subjekteve të ndryshme që ofrojnë ndihmë. Kjo do të ndihmonte më shumë për të parë edhe performancën e shërbimeve të ofruara, për të cilën në këtë monitorim kemi të dhëna të kufizuara.

1.2. Profili i detajuar i viktimave që kanë përfituar ndihmë ligjore nga qendrat e shërbimit.

Tabela 2. Profili i viktimave që kanë përfituar ndihmë ligjore

PROFILI I VIKTIMAVE QË KANË PËRFITUAR NDIHMË Parësore			
	Durrës	Shkodër	Tiranë
viktima të abuzuar seksualisht	-	-	-
viktima të trafikimit të qenieve njerëzore	-	-	-
Viktima të mundshme trafikimi	-	-	-
Viktima të dhunës në familje	13	47	15
viktima të mitur në konflikt me ligjin	-	-	-
persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.	3	1	-

Sikurse vërejmë nga tabela e mësipërme, subjektet që kanë kërkuar dhe kanë përfituar më shumë ndihmë, janë viktimat e dhunës në familje; kurse më pak, kanë kërkuar dhe përfituar subjektet që kanë pësuar diskriminim. Nuk ka pasur kërkesë për ndihmë nga subjekte të tjera të veçanta, si viktimat e dhunës seksuale, të trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe personat e mitur në konflikt me ligjin. Kjo zbrazëti kërkesash shpjegohet me arsye të ndryshme, porse ajo që bie në sy është fakti që subjektet e veçanta që mungojnë, kanë nevojë për më shumë shërbime në procesin penal. Viktimat e dhunës në familje kërkojnë mbrojtje kryesisht, në procesin civil. Ka shumë mundësi që kjo të ketë ndikuar në numrin e pakët të kërkesave për kategoritë e tjera. Është më e mundshme që në qendrat e ndihmës juridike parësore të drejtohen qytetarët që kërkojnë mbrojtje në procesin administrativ e civil, ndërkohë që për mbrojtje në procesin penal, qytetarët i drejtohen kryesisht strukturave të policisë. Për sa më sipër, sjellim në vëmendje se pas ndryshimeve të vitit 2020 të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, çdo raportim i dhunës në familje, përpos rrugës administrative e civile që ndjek në bazë të këtij ligji, ka një lidhje automatike edhe me denoncimin penal përsa ky ligj, ka parashikuar se: “Në çdo rast, punonjësi i policisë, ku paraqitet për mbrojtje viktimat, e referon rastin në organin e prokurorisë për ndjekjen penale të dhunuesit sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.” (neni 24).

Një shkak tjetër që nënvizojmë është shërbimi që ofrohet nga organizatat jofitimprurëse, i cili është i specializuar veçanërisht në shërbimet e viktimave të dhunës me bazë gjinore.

1.3. Shërbimet që janë ofruar në kuadrin e ndihmës juridike parësore nga qendrat e shërbimit

Tabela 3. Numri i subjekteve që kanë marrë ndihmë juridike parësore nga qendrat, sipas rretheve gjyqësore.

SHËRBIMI I KRYER			
	Durrës	Shkodër	Tiranë
a) informim mbi sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;	-	47	-
b) Këshillim	25	42	
c) këshillim mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;	-	2	-
d) ndihmë për hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;	2	33	15
e) përfaqësim përpara organeve administrative;	-	-	-
f) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.	3	-	-

Nga tabela 3 vërejmë se vendin e parë në shërbimet e ofruara në të tri qarqet e zë këshillimi i subjekteve. Ajo çka bën përshtypje është fakti se qendrat e dy qarqeve, përkatësisht qarku Durrës dhe Tiranë, nuk kanë raportuar asnjë rast të kryer për informimin të sistemit ligjor të RSH-së. Ndërkohë, qarku Shkodër ka raportuar 47 raste të informimit, një numër i barabartë ky me numrin e viktimave të dhunës me bazë gjinore që janë mbështetur nga qendra e shërbimeve parësore për këtë qark. Këto të dhëna na krijojnë përshtypjen se ka një keqkuptim në përlllogaritjen e shërbimeve për këto dy zëra. Në fakt, në praktikë, zëri a, informimi, ngjan shumë me zërin b këshillim dhe mund që ato të përzihen me njëra tjetrën si në shërbim ashtu edhe në raportim. Ne gjejmë rastin të nënvizojmë se ka ndryshime midis tyre. Nëse informimi u jepet qytetarëve në përgjithësi në lidhje me kërkesat që ata kanë për të njohur legjislacionin, këshillimi nënkupton këshilla të nevojshme për çështjen konkrete për të cilën palët ankohen apo denoncojnë në këto qendra. Mbi bazën e këtij dallimi duhet të bëhen statistikat dhe raportimet e nevojshme. QSHNJP Tiranë ka mbështetur pesëmbëdhjetë viktima të dhunës në familje në plotësimin e dokumentacionit për të përfituar ndihmë juridike dytësore. Nga të dhënat nuk na rezulton që viktimat të jenë informuar për legjislacionin në tërësi që ofron mbrojtje për dhunën në familje, apo të kenë përfituar këshillim për çështjen konkrete.

2. Ndhimja juridike parësore e ofruar nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara

Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, në shtator të vitit 2020, në të gjithë vendin janë autorizuar 12 OJF për të ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore.

Në rrethin Tiranë, përgjatë vitit 2021 janë autorizuar për të dhënë shërbime ligjore falas 6 organizata si vijojnë:

1. “Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza”
2. “Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA)”
3. “Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)”
4. “Të ndryshëm dhe të barabartë”
5. “Qendra për Nisma Ligjore Qytetare”
6. Qendra “ALTRI”

Këto organizata kanë vijuar shërbimet e tyre përgjatë gjithë vitit 2021. Mjaft prej këtyre organizatave janë specializuar dhe japin ndihmë juridike për mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore, të cilat u bënë objekt monitorimi në kuadër të këtij raportimi. Konkretisht, nga 10 organizata OJF, që janë kontraktuar në këtë fushë në të tri rrethet, 8 prej tyre operojnë në qarkun e Tiranës, kurse në qarqet gjyqësore të Shkodrës dhe Durrësit janë autorizuar nga një organizatë, respektivisht. Monitorimi gjeti se në rrethin Tiranë, nga 8 organizata, 6 prej tyre kanë ofruar ndihmë për mbrojtjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore ose dhunës në familje. Vetëm 2 organizata, të cilat kanë objekt specifikisht të ndryshëm, nuk kanë pasur raste dhune përgjatë vitit 2021. Për shembull qendra për mbrojtjen e konsumatorit ka ofruar shërbime, por jo për kategoritë e posaçme, sipas objektit tonë të monitorimit.

Për sa më sipër, në lidhje me rastet e asistuara në kuadrin e ndihmës juridike parësore paraqesim të dhënat sasiore në vijim, vetëm për rrethin gjyqësor Tiranë, pasi arritëm të kemi të dhëna vetëm prej tyre.

2.1. Numri i subjekteve të kategorive të veçanta që kanë marrë ndihmë juridike parësore nga OJF-të, Tiranë

Tabela 4. OJF që ofrojnë ndihmë juridike parësore në Tiranë

OJF që ofrojnë ndihmë juridike parësore në Tiranë						
	CRCA	Të ndryshëm dhe të barabartë	ALTRI	Qendra e këshillimit për gra dhe vajza	QNL	TLAS
Subjekte të ndihmuara që i përkasin kategorive të veçanta	128	106	29	176	168	144

Nga të dhënat e tabelës më sipër, konstatojmë se në rrethin gjyqësor Tiranë, 6 organizatat e autorizuara kanë ofruar ndihmë juridike parësore për subjektet e kategorive të veçanta të viktimave.

Gjatë hartimit të raportit konstatojmë se do të ishte mirë të kishim të dhëna se si këto organizata bashkëpunojnë me njëra-tjetrën me qëllim referimin e subjekteve për ndihmë tek organizata më e specializuar e fushës. Mendojmë se në të ardhmen duhet të shtohet kjo kërkesë në mbledhjen e të dhënave, pasi na ndihmon për të nxjerrë konkluzione me qëllim që të rritet cilësia e shërbimeve në ofrimin e ndihmës ligjore falas.

2.2. Profili i detajuar i viktimave që kanë përfituar ndihmë ligjore nga OJF-të e autorizuar

Profili i subjekteve të kategorive të veçanta OJF, Tiranë,						
	CRCA	Të ndryshëm dhe të barabartë	ALTRI	Qendra e këshillimit për gra dhe vajza	QNL	TLAS
viktima të abuzuar seksualisht	42	3	0	0	0	0
viktima të trafikimit të qenieve njerëzore	0	20	6	0	1	0
Viktima të mundshme trafikimi	1	16	0	0	1	0
Viktima të dhunës në familje	16	74	0	148	166	73
viktima të mitur në konflikt me ligjin	9	9	10	0	0	18
persona të diskriminuar	0	0	13	0	0	53
të tjera (kategori të veçanta)	59	0	0	28	0	0

Edhe në këtë rast, profili kryesor i viktimave që kanë përfituar ndihmë juridike parësore është viktimë e dhunës në familje. Në katër prej organizatave qëndron ky profil. Ai ndryshon vetëm në dy organizata, të cilat janë të specializuara në mbrojtjen e viktimave nga trafikimi i personave dhe nga diskriminimi. Duhet theksuar se nga gjashtë prej organizatave, mbrojtja nga dhuna në familje është fokusi qendror i dy prej tyre, Qendra e Këshillimit për gra dhe vajza dhe Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare. Ndërkohë, disa organizata të tjera punojnë me fëmijët dhe në këtë kuadër japin ndihmë të specializuar për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në familje.

2.3. Klinikat universitare të autorizuar

Në kuadër të këtij projekti iu nënshtruan monitorimit edhe klinikat universitare të autorizuar mbi bazën e marrëveshjeve me Ministrinë e Drejtësisë për të ofruar ndihmë juridike parësore. Konstatuam se në të tria qarqet gjyqësore janë ngritur dhe funksionojnë një sërë klinikash ligjore pranë universiteteve. Shërbimet ofrohen nga pedagogët avokatë me bashkëpunimin e studentëve. Ato iu nënshtruan monitorimit të avokateve të QNL-së.

Konkretisht, u monitoruan klinikat universitare të Universitetit Luigj Gurakuqi në Shkodër, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës, si dhe klinikat e Universiteteve në Tiranë, që kanë lidhur marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë.

Në qytetin e Tiranës, Drejtoria e Ndhmës juridike falas ka nënshkruar 8 marrëveshje bashkëpunimi me klinikat ligjore që ndodhen pranë universiteteve publike dhe private.

Gjatë vitit 2021 vetëm Klinika e Ligjit pranë Universiteti "Luarasi" ka ofruar ndihmë juridike parësore për 1 (një) viktimë të dhunës në familje duke e këshilluar dhe plotësuar formularët për përfitimin e ndihmës juridike dytësore.

IV.

REZULTATET NGA MONITORIMI I NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE

1. Një vështrim i ndihmës juridike dytësore sipas ligjit

Ligji nr. 111/2017, Për ndihmën juridike të garantuar nga Shteti, përcakton kriteret dhe procedurat për përfitimin e ndihmës juridike dytësore falas. Kriteret që duhet të përmbushin kërkuesit janë vendosur në dispozita të njëjta sikurse për format e tjera të ndihmës juridike që ofrohen në bazë të këtij ligji. Kurse procedurat për të përfituar ndihmën juridike dytësore janë të ndryshme dhe të trajtuara në mënyrë të detajuar.

Ndihma juridike dytësore përfshin procesin për përfaqësimin e personit përpara gjykatës nga avokatët e autorizuar në çështje gjyqësore. Por edhe vetë ndihma juridike dytësore bëhet e mundur për kërkuesin, në sajë të procesit gjyqësor, mbi bazën e kërkesës së të interesuarit dhe vendimit të gjykatës. I gjithë procesi për ta përfituar atë përbëhet nga disa hapa proceduralë siç janë: Kërkesa, Shqyrtimi i kërkesës dhe Ofrimi i ndihmës dytësore falas. Këto hapa proceduralë kanë qenë edhe objekt i monitorimit tonë pranë gjykatave në të tri rrethet gjyqësore.

Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet nga personi i interesuar personalisht, ose me anë të shërbimit postar pranë gjykatës ose organit procedues që fillon hetimet, përpara fillimit të një procesi gjyqësor, në fillim të një procesi gjyqësor dhe/ose në çdo fazë të procesit gjyqësor, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin procedural.

Gjykata shqyrton kërkesën për ndihmën juridike dytësore në përputhje me parashikimet në legjislacionin procedural dhe, për aq sa është e mundur, me dispozitat e këtij ligji. Vendimi në lidhje me pranimin ose jo, të kërkesës për ndihmë juridike dytësore merret nga gjykata kompetente. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore mund të rrëzohet vetëm në dy raste: kur nuk përmbushen kushtet e parashikuara nga ligji për kriteret e përfitimit të ndihmës juridike me të ardhura të pamjaftueshme, si dhe kur kërkesa është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar.


2. Rezultatet nga monitorimi i vendimeve për përfitimin e ndihmës juridike dytësore dhe përjashtimin nga shpenzimet

2.1. Vendimet gjyqësore që u monitoruan.

Vendimet që u monitoruan u përzgjedhën në fokusin e monitorimit. Ato dëshmojnë se si është duke u formuar praktika gjyqësore për të përmbushur kërkesat për ndihmën juridike dytësore, pra, kërkesat për të pasur një avokat me qëllim që ta përfaqësojë në gjykim dhe kërkesat për t'u përjashtuar nga tarifat e shpenzimet gjyqësore.

Tabela. 6

	TOTALI I VENDIMEVE TË MONITORUARA	Vendime për përfitimin e ndihmës juridike dytësore	Vendime për përjashtimin nga tarifat e shpenzimet gjyqësore	Vendime për përfitimin e ndihmës juridike dytësore & përjashtim nga tarifat e shpenzimet gjyqësore
<i>Shkodër</i>	13	2	10	1
<i>Tiranë</i>	21	2	9	10
<i>Durrës</i>	12	2	4	6



Të dhënat e ofruara nga tabela dhe grafiku i mësipërm, flasin për ecurinë e zbatimit të ligjit në të tri rrethet. Numri më i lartë i vendimeve është dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjë që është e pritshme për shkak të numrit më të lartë të kërkesave, që ndikohet edhe nga numri më i lartë i popullsisë. Nga numri i kërkesave, duket se në të tri rrethet ka ndërjegjësim për të paraqitur kërkesa në emër të subjekteve të posaçme.

Është e pritshme që numri më i lartë i vendimeve të jetë në lidhje me përjashtimin nga tarifat e shpenzimet gjyqësore për shkak të pamjaftueshmërisë të të ardhurave. Por megjithatë, të bën përshtypje fakti se ka një numër të lartë çështjesh me këtë objekt, të veçuar nga objektet e tjera. Kjo është e lidhur veçanërisht me rastet kur ndihma dytësore me avokat ofrohet nga avokatët e organizatave jofitimprurëse, të cilat janë të afta të thithin fonde dhe janë specializuar për

mbrojtjen e të drejtave të grave. Megjithatë ka edhe ndonjë rast kur pala përfaqësohet nga një avokat privat, por meqenëse i përmbush kriteret kërkon përjashtimin nga shpenzimet.

3. Profili i viktimave

Profili i viktimës	Numri i rasteve		
	Shkodër	Tiranë	Durrës
Viktimë e dhunës në familje;	13	11	8
viktima të abuzuar seksualisht, në çdo fazë të procedimit penal;	0	1	0
viktima të trafikimit të qenieve njerëzore në çdo fazë të procedimit penal;	0	0	0
viktima të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;	0	0	0
persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.	0	0	0

Tabela e mësipërme bazohet në kategoritë e ndryshme të subjekteve të posaçme që përfitojnë ndihmë juridike. Nga të dhënat e saj kuptojmë qartë se viktimat e dhunës në familje janë subjektet që kanë përfituar më shumë ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga shpenzimet. Kjo ndodhte edhe për ofrimin e këshillimit dhe elementeve të tjera të ndihmës juridike parësore.

Viktimat e dhunës seksuale e kanë kërkuar dhe përfituar këtë ndihmë në një rast të vetëm, në Tiranë.

Në çdo rast, gjykojmë se mbështetja ligjore dhe ajo institucionale, si dhe e shoqërisë civile, është e fokusuar në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje, ndërkohë që ka nevojë për më shumë mbështetje në të gjitha aspektet për viktimat e dhunës ndaj grave. Është fjala për rastet e dhunës ndaj grave që jo medoemos ushtrohet nga anëtarët e familjes, në mënyrë të veçantë viktimave të trafikimit.

Gjithashtu, nga kjo tabelë kuptojmë se viktimat duhet të kenë mbështetje dhe përfaqësim edhe në proceset për të kërkuar ndihmën juridike dytësore dhe përjashtimin e shpenzimeve. Kuptohet se në numrin shumë të ulët të rasteve, përpos të tjerave, ka ndikuar edhe mungesa e përfaqësimit. Përfaqësimi i tyre nga qendrat e ndihmës juridike, nga organizatat e shoqërisë civile ose klinikat e ligjit, do të rrisë gamën e këtyre shërbimeve.

4. Lloji i çështjes

Lloji i Çështjes	Numri i rasteve		
	Shkodër	Tiranë	Durrës
UMM/UM (Vërtetim UMM)	3	0	0
vepra penale të dhunës në familje	0	0	0
vepra penale të ngacmimit seksual;	0	1	0
Zgjidhje martese	8	10	5
Heqje e përgjegjësisë prindërore	1	0	0
Marrjen e masës së përkohshme së kujdestarisë	1	0	0
Dhënie autorizimi për lejim për të lëvizur me fëmijën e mitur jashtë vendit	0	1	1
Kundërshtimin e atësisë së prezumuar për fëmijët e mitur	0	0	1
Ankim për kundërshtimin e vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për mosfillimin e procedimit penal	0	0	1

Duke marrë në konsideratë llojin e çështjeve, numrin më të madh të vendimeve e zënë çështjet me objekt zgjidhje martese. Këto çështje shoqërohen me disa lloje shpenzimesh, në të cilat përfshihen edhe shpenzimet për ekspertin, shpenzime të cilat kanë ardhur në rritje. Nga ana tjetër duhet të mbajmë në vëmendje faktin se, periudha e divorcit është një periudhë e rëndë krize, e cila shoqërohet sidomos, edhe me krizë ekonomike. Pra, përgjatë divorcit, në përgjithësi gratë ndodhen në pozita vulnerabiliteti ekonomik, jo vetëm për shkak të pamjaftueshmërisë së të ardhurave që kanë zakonisht, por edhe për shkak të krizës që shtohet në këtë periudhë.

5. Paraqitja e kërkesës në gjykatë

	Paraqitja e kërkesës në gjykatë	
	<i>Nga personi, i cili gëzon të drejtën për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore.</i>	<i>Nga një përfaqësues ligjor apo i pajisur me prokurë, ose nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja ose i afërm i shkallës së parë.</i>
Shkodër	10	3
Tiranë	11	1
Durrës	8	0

Nga kjo tabelë konstatojmë se numri i përfaqësuesve të viktimave është shumë i ulët. Kjo mund të ketë disa shkaqe. Mund të lidhet me faktin se të gjithë subjektet që ofrojnë ndihmë ligjore falas janë fokusuar më tepër në informim e këshillim, pra informojnë subjektet dhe përgatisin paraprakisht aktet, por nuk paraqiten në gjykatë.

Megjithatë, nga përvoja jonë si avokatë gjykojmë se një numër kaq i ulët përfaqësimi në këto çështje, mund të vijë edhe për shkak të mos dokumentimit të rregullt të përfaqësimit apo të emrit të përfaqësuesit në vendimet gjyqësore. Ka ndodhur edhe në raste të tjera, që gjykata në zbardhjen e vendimit nuk kujdeset aspak për të treguar faktin se pala është përfaqësuar dhe nga kush është përfaqësuar. Ndodh shpesh që ajo i referohet drejtpërdrejt emrit të palës kërkuese.

Nga ana tjetër, në shumicën e rasteve përfaqësuesit kryejnë punën e tyre pa i firmosur aktet apo kërkesat që depozitojnë në emrin e tyre, por në emrin e palës.

Pavarësisht nga sa më sipër, mendoj se kjo situatë krejtësisht e varfër sa i përket përfaqësimit, duhet të na nxisë për të gjetur shkaqet e vërteta dhe për të luftuar për rritjen e përfaqësimit dhe të mbështetjes për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, si subjekte të posaçme të këtij ligji.

Momenti procedural i paraqitjes së kërkesës			
	<i>Përpara fillimit të procesit gjyqësor</i>	<i>Në fillim të procesit gjyqësor, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor</i>	<i>Në çdo fazë të procesit gjyqësor derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor</i>
Shkodër	4	6	3
Tiranë	9	0	2
Durrës	5	3	0

Është pozitiv fakti që pjesa më e madhe e kërkesave për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga shpenzimet e procesit gjyqësor, paraqitet në fillim të procesit. Kjo është një shenjë e mirë si për mbarëvajtjen e procesit gjyqësor, ashtu edhe një garanci për të gëzuar këtë të drejtë subjektet e posaçme që kanë qenë në fokus të këtij monitorimi. Sidoqoftë, të gjitha të dhënat e kësaj tablele japin konkluzione pozitive, pasi dëshmojnë se po krijohet praktika gjyqësore sipas së cilës, në çdo fazë të procesit, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor, është pranuar kërkesa dhe është njohur çdo moment procedural i vlefshëm për paraqitjen e saj. Edhe ky fakt është një garanci për nevojtarët për ndihmën juridike dytësore dhe për përjashtimin nga shpenzimet.

6. Provueshmëria

Provueshmëria		
	<i>Kërkesa pranuar mbi bazën e provave shkresore</i>	<i>Janë kryer hetime të thelluara për të ardhurat</i>
Shkodër	13	0
Tiranë	9	2
Durrës	6	2

Kjo tabelë na tregon se praktika gjyqësore i njuh të dyja mundësitë e provueshmërisë të kërkesës. Gjykata ka pranuar kërkesën si në rastin kur ajo është bazuar në provat shkresore, ashtu edhe në rastin kur janë kryer hetime të thelluara. Tabela dëshmon se rastet kur kërkesa është pranuar mbi bazën e provave shkresore të paraqitura nga pala, janë më të shumta se sa rastet kur janë kryer hetime të thelluara për të ardhurat. Raporti në favor të provueshmërisë vetëm mbi bazën e provave shkresore të paraqitura nga pala kërkuese, dëshmon se kjo është praktika më e zakonshme e Gjykatës dhe njëkohësisht, ajo është edhe praktika më lehtësuese për palët, si dhe më pak e kushtueshme në kohë e financë për gjykatën vetë. Këtë e shohim si një praktikë të mirë, pasi nuk e vonon procesin.

Të gjitha subjektet që ofrojnë ndihmë në këto raste, nxjerrin mësim nga kjo tabelë që të kryejnë një përgatitje serioze dhe të saktë të të gjithë dokumentacionit bashkëshoqërues.

V.

PËRMBLEDHJE E KONKLUZIONEVE DHE REKOMANDIMEVE

1. Gjetjet kryesore nga monitorimi

1.1 Në lidhje me infrastrukturën institucionale

- Përgjatë periudhës objekt monitorimi gjejmë se, jo vetëm është krijuar kuadri i nevojshëm ligjor për ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, por edhe janë vënë në zbatim ligji dhe aktet nënligjore të tij. U konstatua se në të tria rrethet objekt monitorimi janë garantuar shërbime ligjore falas të ndihmës juridike parësore.
- Në bazë të ligjit, janë krijuar dhe funksionojnë qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, organizatat jofitimprurëse të autorizuara dhe klinikat ligjore, të ofrojnë ndihmë juridike parësore falas për çdo subjekt përfitues. Të gjitha këto institucione kanë vendosur në dispozicion të qytetarëve zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve. Por, konstatuam se vetëm disa prej tyre janë të aksesueshme edhe nga persona me aftësi ndryshe.
- Aktualisht, në të gjithë vendin janë autorizuar OJF, për të ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore. Mjaft prej këtyre organizatave janë specializuar dhe japin ndihmë juridike për mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore. Konkretisht, nga 10 organizata OJF, që janë kontraktuar në këtë fushë në të tria rrethet, 8 prej tyre operojnë në qarkun e Tiranës, 6 prej të cilave kanë ofruar ndihmë për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Kurse, në qarqet gjyqësore të Shkodrës dhe Durrësit janë autorizuar nga një organizatë, respektivisht.
- Në qytetin e Tiranës, Drejtoria e Ndihmës juridike falas ka nënshkruar 8 marrëveshje bashkëpunimi me klinikat ligjore që ndodhen pranë universiteteve publike dhe private. Por, gjatë vitit 2021, vetëm Klinika e Ligjit pranë Universitetit “Luarasi” ka ofruar ndihmë juridike parësore për 1 (një) viktimë të dhunës në familje.
- Gjatë monitorimit nuk arritëm të evidentojmë procedurat e koordimit dhe të referimit të rasteve të dhunës ndaj kategorive të veçanta midis institucioneve të mësipërme që ofrojnë ndihmë ligjore falas.

1.2 Në lidhje me subjektet që kanë përfituar ndihmë ligjore falas

- Në të gjitha rastet, subjektet e posaçme që kanë kërkuar dhe kanë përfituar më shumë ndihmë juridike falas, janë viktimat e dhunës në familje. Kërkesa më të pakta ka pasur nga subjekte të tjera të veçanta, si viktimat e dhunës seksuale, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe personat e mitur në konflikt me ligjin.
- Nga i gjithë monitorimi, është evidentuar vetëm një rast i dhunës seksuale. Gjasat dëshmojnë se edhe dhuna seksuale është e përhapur, por ende nuk po raportohet dhe denoncohet në shkallën që duhet, për shkak të mosndërgjegjësimit, paragjytimeve etj.
- Pranë qendrave të ndihmës juridike falas, janë në përqindje të vogël subjektet e veçanta që marrin shërbime. Kjo ka njëfarë shpjegimi me rolin plotësues të OJF-ve, të cilat siç shihet, kanë pasur volumin më të madhe të shërbimeve me këtë kategori përgjatë gjithë vitit.
- Klinikat e ligjit pranë universiteteve janë larg shërbimeve ndaj këtyre kategorive.

1.3 Në lidhje me shërbimet e ofruara dhe gjetjet në fushën juridike

- Në tërësi nga monitorimi rezultoi se janë krijuar praktika të shumta për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga institucionet që e ofrojnë këtë ndihmë.
- Numri i shërbimeve dhe i gjyqimeve varion nga njëri rreth gjyqësor në tjetrin, jo sipas ndonjë rregulli të caktuar, por për shkaqe të ndryshme, disa prej të cilave janë evidentuar përgjatë këtij raporti. Evidentuar se Qendra e ndihmës juridike falas në Tiranë ka ofruar më pak shërbime sesa qendrat simotra në Durrës dhe në Shkodër. Mendojmë se për këtë fakt ka disa shkaqe. Porse, ndikon veçanërisht vendndodhja e kësaj qendre, e cila funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë, një institucion qendror larg gjykatave, me akses më të kufizuar se sa qendrat që janë ngritur dhe funksionojnë pranë gjykatave.
- Konstatuar se, është duke u konsoliduar praktika gjyqësore për të përmbushur kërkesat për ndihmën juridike dytësore, pra, për të pasur një avokat me qëllim që ta përfaqësojë në gjykim, si dhe kërkesat për t'u përjashtuar nga tarifat e shpenzimet gjyqësore.
- Praktikët duket se janë të unifikuara në përgjithësi. Por, nënvizojmë se nevojitet një qartësim midis informimit si shërbim dhe këshillimit. Ne mendojmë se gjatë raportimit ato janë ngatërruar me njëri-tjetrin dhe ka nevojë të sqarohen.
- Numri i përfaqësuesve të viktimave, së paku nga vendimet, rezulton të jetë shumë i ulët. Kjo mund të ketë disa shkaqe. Mund të lidhet me faktin se të tëra subjektet që ofrojnë ndihmë ligjore falas janë fokusuar më tepër në informim e këshillim, pra informojnë subjektet dhe përgatisin paraprakisht aktet, por nuk paraqiten në gjykatë. Megjithatë, nga përvoja jonë si avokatë gjykojmë se një numër kaq i ulët përfaqësimi në këto çështje, mund të vijë edhe për shkak të mos dokumentimit të rregullt të përfaqësimit apo të emrit të përfaqësuesit në vendimet gjyqësore.
- Sikurse pritej, numri më i lartë i vendimeve ka objekt përjashtimin nga tarifat e shpenzimet gjyqësore për shkak të pamjaftueshmërisë të të ardhurave. Por megjithatë,

të bën përshtypje fakti se ka një numër të lartë çështjesh me këtë objekt, të veçuar nga kërkimi i ndihmës dytësore. Kjo ka ndodhur për shkaqe të ndryshme, por sidomos për shkak se në mjaft raste, avokati i ndihmës dytësore vjen nga organizatat jofitimprurëse, për të cilin nuk paraqitet kërkesë në gjykatë.

- Numrin më të madh të vendimeve e zënë çështjet me objekt zgjidhje martesë. përgjatë divorcit, gjë që është e kuptueshme pasi në përgjithësi, gratë ndodhen në pozita vulnerabiliteti ekonomik, jo vetëm për shkak të pamjaftueshmërisë së të ardhurave që kanë zakonisht, por edhe për shkak të polikrizës që shtohet në këtë periudhë.
- Rastet kur kërkesa është pranuar mbi bazën e provave shkresore të paraqitura nga pala, janë më të shumta se sa rastet kur janë kryer hetime të thelluara për të ardhurat. Kjo është praktika më e zakonshme e Gjykatës dhe njëkohësisht, është edhe praktika më lehtësuese për palët, si dhe më pak e kushtueshme në kohë e financë për gjykatën vetë.
- Kërkesa për ndihmë juridike dytësore është paraqitur dhe pranuar nga gjykata në çdo fazë të procesit, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor. Gjykojmë se kjo praktikë është e dobishme dhe në interes të palëve.

2. Rekomandime

- Mbështetja ligjore dhe ajo institucionale, si dhe e shoqërisë civile, ka nevojë të forcohet dhe të drejtohet për më shumë mbështetje për viktimat e dhunës ndaj grave, përpos viktimave të dhunës në familje. (Është fjala për rastet e dhunës ndaj grave që jo medoemos ushtrohet nga anëtarët e familjes, në mënyrë të veçantë viktimave të trafikimit).
- Ka nevojë të rritet kontributi i organizatave të shoqërisë civile, i qendrave të ndihmës juridike dhe i klinikave të ligjit, për ndërgjegjësimin e shoqërisë për të denoncuar rastet e dhunës seksuale dhe të mbështesë viktimat e kësaj dhune për të kërkuar ndihmë juridike.
- Puna për ndërgjegjësimin e shoqërisë ka nevojë të forcohet edhe për të ngritur opinionin dhe për të raportuar rastet e tjera të dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë gjinore, si dhe për të përfituar ndihmën ligjore falas.
- Ka nevojë për forcimin e bashkëpunimit dhe të koordinimit midis tyre në menaxhimin e rastit midis institucioneve dhe organizatave, me qëllim që të ofrohet një ndihmë ligjore falas efikase dhe e specializuar.
- Është absolutisht e nevojshme që të rishikohet vendndodhja e qendrës së shërbimit juridik falas të Tiranës. Ajo duhet të zhvendoset nga Ministria e Drejtësisë drejt gjykatave të shkallës së parë, në përputhje me ndryshimet e hartës gjyqësore.
- Mjediset e qendrave, organizatave dhe klinikave që ofrojnë ndihmë juridike parësore kanë detyrimin të përshtatin mjediset e tyre për t'u bërë të aksesueshme për personat me aftësi ndryshe. Së paku duhet të realizojnë sa më parë një përshtatje minimale, p.sh., të rampës.

- Është e nevojshme që të përfshihen më shumë klinikat universitare të ligjit për ndihmën ligjore falas ndaj kategorive të veçanta në nevojë. Kjo do të sillte mjaft përfitime edhe për forcimin e ndihmës falas edhe në ardhmen, parë që përcjellja e punës përmes studentëve e krijon këtë mundësi.
- Qendrat, organizatat dhe klinikat që japin ndihmë ligjore falas kanë detyrimin që të forcojnë kapacitetet e avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike parësore në të gjitha format. Avokatët duhet t'u nënshtrohen trajnimeve të vazhdueshme për përditësimin e njohurive të tyre.
- DNJF-ja duhet të marrë masat me qëllim që të përditësojë në mënyrë sistematike njohuritë dhe përgatitjen e avokatëve që japin ndihmë juridike parësore.
- DNJF-ja duhet të identifikojë organizata të shoqërisë civile në rrethet e tjera gjyqësore përpos Tiranës dhe të autorizojë organizata e specializuara. Për këtë ajo duhet të mbajë parasysh edhe ndryshimet që do të vijnë me hartën e re gjyqësore.
- Qendrat, organizatat dhe klinikat që japin ndihmë ligjore falas duhet të rrisin të kontributin e tyre në proceset e informimit dhe të këshillimit të personave. Nëse informimi u jepet qytetarëve në përgjithësi në lidhje me kërkesat që ata kanë për të njohur legjislacionin, këshillimi nënkupton këshilla të nevojshme për çështjen konkrete për të cilën palët ankohen apo denoncojnë në këto qendra.

VI.

ANEX

Skeda e Monitorimit

Skeda e Monitorimit

Ligj nr.111/2017 "Për ndihmën Juridike të garantuar nga Shteti"

1.a Ndihmë parësore

1.a.1.Kategoria e qendres	Shëno me X	Shënime
a) "Qendër shërbimi e ndihmës juridike parësore"		
b) Klinikat e Ligjit pranë Universiteteve		
c) Organizatat jo fitimprurëse të autorizuara nga MD		

1.a.2 - Profili i viktimës	Shëno me X	Shënime
a) Viktimë e dhunës në familje;		
b) viktimave të abuzuar seksualisht, në çdo fazë të procedimit penal;		
c) viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore në çdo fazë të procedimit penal;		
d) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;		
e) persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.		

1.a.3 - Cfarë shërbimi ka përfituar	Shëno me X	Shënime
a) dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;		
b) dhënia e këshillimit;		

c) dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;		
d) dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;		
e) përfaqësimi përpara organeve administrative;		
f) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.		

1.a.4 - Objekti i çështjes	Sheno me X	Shenime
a) UMM/UM		
b) vepra penale të dhunës në familje		
c) vepra penale të ngacimit seksual;		
d) vepra penale të marrëdhënies seksuale me dhunë në marrëdhëniet familjare;		
e) vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore dhe trafikimit të të miturve;		
f) çështje diskriminimi për shkak të gjinisë ose diskriminimi të shumëfishtë, ku një nga shkaqet është gjinia;		

1.a.5 - Baza ligjore	Shëno me X	Shënime
a) Ligji nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe aktet e tij nënligjore		
b) Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ndryshuar; Kodi Penal i republikës së Shqipërisë, i azhornuar, Kodi Procedures Penale.		
c) Të tjera (specifiko)		

1.a.6 - Burimet për monitorim:	Shëno me X	Shënime
a) Formularet + aktet e hartuara nga qendra e ndihmës parësore,		
b) Intervistat me profesionistët e qendrave të kategorive të ndryshme		
c) Intervistat me vetë viktimat e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje		
d) Të tjera (specifiko)		

1.b. Ndihmë dytësore

1.b/1. VENDIMET E GJYKATAVE CIVILE:		
1.b/1.1 - Kategoria e çështjes (viktima ka ose është në process për um,ummm?)	Shëno me X	Shënime
a) UMM/UM;		
b) vepra penale të dhunës në familje;		
c) vepra penale të ngacimit seksual;		

d) vepra penale të marrëdhënies seksuale me dhunë në marrëdhëniet familjare;		
e) vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore dhe trafikimit të të miturve;		
f) çështje diskriminimi për shkak të gjinisë ose diskriminimi të shumëfishtë, ku një nga shkaqet është gjinia;		
g) Të tjera (specifiko)		

1.b/1.2 - Profili i viktimës	Shëno me X	Shënime
a) Viktimë e dhunës në familje;		
b) viktimave të abuzuar seksualisht, në çdo fazë të procedimit penal;		
c) viktima të trafikimit të qenieve njerëzore në çdo fazë të procedimit penal;		
d) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;		
e) persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi;		
f) Të tjera (specifiko)		

1.b/1.3 - Kush ka paraqitur kërkesën?	Shëno me X	Shënime
a) personi, i cili gëzon të drejtën për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore;		
b) një përfaqësues ligjor apo i pajisur me prokurë, ose nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja ose i afërm i shkallës së pare;		
c) Të tjera (specifiko)		

1.b/1.4 - Cfarë shërbimi ka përfituar/me cilin objekt të çështjes,	Shëno me X	Shënime
a) përpilimi i akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën;		
b) ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtja para gjykatës në çështjet administrative,		
c) ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet civile		
d) ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.		
e) Të tjera (specifiko)		

1.b/1.5 - Kur është paraqitur kërkesa për ndihmë juridike dytësore?	Shëno me X	Shënime
a) përpara fillimit të procesit gjyqësor;		
b) në fillim të procesit gjyqësor, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor;		
c) në cdo fazë të procesit gjyqësor derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor;		
d) Të tjera (specifiko)		

1.b/1.6 - Cfarë qëndrimi dhe cfarë ka kërkuar Avokati i çështjes?

1.b/1.7 - A është avokati i çështjes në listën e avokatëve të miratuar për këtë shërbim?	Shëno me X	Shënime
PO		
JO		
Të tjera (specifiko)		

1.b/1.8 - A ka vendim të gjykatës që shprehet për kërkesën për të përfituar ndihmë ligjore falas,	Shëno me X	Shënime
PO		
JO		
Të tjera (specifiko)		

1.b/1.9 - A është pranuar kërkesa automatikisht, apo janë kryer hetime për të ardhurat?	Shëno me X	Shënime
PO		
JO		
Të tjera (specifiko)		

1.b/1.10 - A ka përfunduar gjykimi i çështjes?	Shëno me X	Shënime
PO		
JO		
Të tjera (specifiko)		

1.b/1.11 - A janë pranuar kërkimet e viktimës së dhunës në familje?	Shëno me X	Shënime
PO		
JO		
Të tjera (specifiko)		

1.b/1.12 - Baza ligjore	Shëno me X	Shënime
a) Ligji nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" dhe aktet e tij nënligjore		
b) Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", ndryshuar; Kodi Penal i republikës së Shqipërisë, i azhornuar		
c) Të tjera (specifiko)		

1.b/2 VENDIMET E GJYKATAVE PENALE:

1.b/2.1 - Kategoria e çështjes (viktimë e cilës veprë penale është)?	Shëno me X	Shënime
a) vepra penale të dhunës në familje		
b)vepra penale të ngacmimit seksual;		
c)vepra penale të marrëdhënies seksuale me dhunë në marrëdhëniet familjare;		
d)vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore dhe trafikimit të të miturve;		
e) Të tjera (specifiko)		

1.b/2.2 - Profili i viktimës	Shëno me X	Shënime
a)Viktimë e dhunës në familje;		
b) viktimave të abuzuar seksualisht, në çdo fazë të procedimit penal;		
c)viktima të trafikimit të qenieve njerëzore në çdo fazë të procedimit penal;		
d) viktima të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;		
e) Të tjera (specifiko)		

1.b/2.3 - Çfarë shërbimi ka përfituar/me cilin objekt të çështjes,	Shëno me X	Shënime
a) përpilimi i akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën;		
b) ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtja para gjykatës në çështjet administrative,		
c) ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet civile		
d) ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.		
e) Të tjera (specifiko)		

1.b/2.4 - Cfarë qëndrimi dhe cafrë ka kërkuar Avokati i çështje

1.b/2.5 - A është avokati i çështjes në listën e avokatëve të miratuar për këtë shërbim?	Shëno me X	Shënime
PO		
JO		
Të tjera (specifiko)		

1.b/2.6, A ka vendim të gjykatës që shprehet për kërkesën për të përfituar ndihmë ligjore falas,	Shëno me X	Shënime
PO		
JO		
Të tjera (specifiko)		

1.b/2.7, a është pranuar kërkesa automatikisht, apo janë kryer hetime për të ardhurat?	Shëno me X	Shënime
PO		
JO		
Të tjera (specifiko)		

1.b/2.8, A ka përfunduar gjykimi i çështjes?	Shëno me X	Shënime
PO		
JO		
Të tjera (specifiko)		

1.b/2.9 - A janë pranuar kërkimet e viktimës së dhunës në familje?	Shëno me X	Shënime
PO		
JO		
Të tjera (specifiko)		

1.b/2.10 - Baza ligjore	Shëno me X	Shënime
a) Ligji nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe aktet e tij nënligjore		

b) Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", ndryshuar; Kodi Penal i republikës së Shqipërisë, i azhornuar		
c) Kodi i Procedurës Penale		
d) Të tjera (specifiko)		

1.b/2.11 - Burimet per monitorim nga:	Shëno me X	Shënime
a) Vendimet e gjykatës		
b) Process verbale dhe formularë që dokumentojnë ofrimin e ndihmës juridike dytësore nga avokatët dhe OJF-të që ofrojnë ndihmë juridike dytësore		
c) Monitorimi i seancave gjyqësore		
d) Monitorimi i dokumenteve me shkrim		
e) Intervistat me profesionistët		
f) Intervistat me vetë viktimat.		
g) Të tjera (specifiko)		

1.b/3 VENDIME TE GJYKATËS CIVILE PËR PËRJASHTIMIN NGA PAGIMI I TARIFAVE GJYQËSORE, SHPENZIMEVE GJYQËSORE DHE DETYRIMI PËR PARAPAGIM TË TARIFAVE TË VËNIES NË EKZEKUTIM TË URDHRI TË EKZEKUTIMIT;

1.b/3.1 - Kategoria e çështjes (viktima ka ose është në process për UM,UMMM?);	Shëno me X	Shënime
a) UMM/UM		
b) vepra penale të dhunës në familje		
c) vepra penale të ngacmimit seksual;		
d) vepra penale të marrëdhënies seksuale me dhunë në marrëdhëniet familjare;		
e) vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore dhe trafikimit të të miturve;		
f) çështje diskriminimi për shkak të gjinisë ose diskriminimi të shumëfishtë, ku një nga shkaqet është gjinia;		
g) Shpërblim dëmi		
Të tjera (specifiko)		

1.b/3.2 - Profili i viktimës	Shëno me X	Shënime
a) Viktimë e dhunës në familje;		
b) viktimave të abuzuar seksualisht, në çdo fazë të procedimit penal;		
c) viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore në çdo fazë të procedimit penal;		
d) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;		

e) persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.		
Të tjera (specifiko)		

1.b/3.3 - Kur është paraqitur kërkesa? Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore është paraqitur:	Shëno me X	Shënime
a) së bashku me kërkesën për ndihmë juridike dytësore;		
b) bashkëlidhur kërkesëpadisë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural;		
c) në çdo fazë të procesit, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor.		
Të tjera (specifiko)		

1.b/3.4 - Kush ka paraqitur kërkesën?	Shëno me X	Shënime
a) personi, i cili gëzon të drejtën për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore,		
b) një përfaqësues ligjor apo i pajisur me prokurë, ose nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja ose i afërm i shkallës së pare;		
c) Në kërkesën për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore është kërkuar përjashtimi nga pagimi i një, disa ose të gjitha tarifave gjyqësore dhe/ose i shpenzimeve gjyqësore _____		
d) Të tjera (specifiko)		

1.b/3.5 - Baza ligjore	Shëno me X	Shënime
a) Ligji nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” dhe aktet e tij nënligjore		
b) Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ndryshuar;		
c) Kodi I Procedurës Penale		
d) Kodi I Procedurës Civile		
e) Ligji për Përmbarrimin		
f) Të tjera (specifiko)		

1.c. ANKIMI. PËRMES MONITORIMIT TË VENDIMEVE TË GJYKATËS SË APELIT DHE PRAKTIKËS SË OJF-VE DHE ORGANEVE ADMINISTRATIVE PRANE MD

1.c.1 - A ka kërkesë ankimore nga Viktima për mospranim të kërkesës për ndihmë ligjore falas?	Shëno me X	Shënime
PO		
JO		
Të tjera (specifiko)		

1.c.2 - Cilit prej subjekteve i është drejtuar ankimi?	Shëno me X	Shënime
a) Gjykatës së Apelit		
b) OJF-së, kur kërkesa për ndihmë juridike dytësore është paraqitur pranë saj		
c) Organeve administrative pranë Ministrisë së Drejtësisë?		
d) Të tjera (specifiko)		

1.c.3 Cilat janë shkaqet e ankimit?

1.c.4 Cilat janë kërkesat e viktimës?

1.c.5 Si është përgjigjur subjekti ndaj të cilit është drejtuar ankimi?